

Ligji Nr. 10076/2009 “Per Sigurimin e detyrueshem ne sektorin e transportit”:

Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim.

Gjatë përdorimit të mjetit të transportit në trafik, drejtuesi është i detyruar të mbajë me vete policën e sigurimit ose çdo provë tjetër të lidhjes së kontratës së sigurimit, si dhe ta paraqesë atë sa herë i kërkohet nga personi zyrtar i autorizuar. Në ndryshim nga pika 1 e këtij neni, transportuesi ajror ose drejtuesi i avionit është i detyruar ta paraqesë policën e sigurimit ose ndonjë provë tjetër të lidhjes së kontratës së sigurimit të detyrueshëm para lëvizjes së avionit, me kërkesë të personit të autorizuar. Në rast aksidenti, drejtuesi është i detyruar të japë të dhënat personale dhe të dhënat, që lidhen me sigurimin e detyrueshëm, sipas këtij ligji, tek të gjithë personat e përfshirë në aksident, të cilëve mund t'u lindë e drejta të kërkojnë dëmshpërblim.

Pronarët e mjeteve të transportit publik të pasagjerëve janë të detyruar të lidhin kontratë për sigurimin e aksidenteve të pasagjerëve në transportin publik.

Pasagjeri i përfshirë në një aksident ose përfituesi, në rastin kur pasagjeri vdes, ka të drejtë, sipas kushteve të kontratës së sigurimit, të kërkojë që shoqëria e sigurimit, me të cilën është lidhur kontrata e sigurimit, të paguajë detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë drejtpërdrejt tek ai.

Kur pronari i një mjeti transporti, që ka lidhur një kontratë për sigurimin e pasagjerëve në transportin publik, është përgjegjës për dëmin e ndodhur, çdo kompensim i dëmeve ndaj palëve të dëmtuara, sipas sigurimit të përgjegjësive, që rezulton nga përdorimi i mjetit të transportit, nuk përfshin shumën që u përket palëve të dëmtuara, sipas sigurimit të detyrueshëm të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik.

Pronari i mjetit motorik detyrohet të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësive për dëmet që mund t'u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, me pasojë dëmtimin dhe humbjen e pronës dhe dëmin jopasuror, në rast vdekjeje, të dëmtimeve trupore dhe përkeqësimit të shëndetit.

Drejtuesi i mjetit motorik me regjistrim të huaj, i cili nuk ka një dokument ndërkombëtar të vlefshëm të sigurimit të përgjegjësive, sipas pikës 1 të nenit 32 të këtij ligji, është i detyruar të lidhë kontratë për sigurimin e përgjegjësive nga përdorimi i mjetit motorik (sigurim kufitar), të vlefshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, me periudhë vlefshmërie, që mbulon periudhën e qëndrimit të tij, por jo më pak se 15 ditë.

Pjesëmarrësit e përfshirë në një aksident rrugor, përveç procesverbalit të konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore, duhet të plotësojnë, të nënshkruajnë dhe të shkëmbejnë vërtetimin miqësor të ngjarjes, sipas një formulari të miratuar nga autoriteti. Formulari i plotësuar me korrektësi mund të përdoret nga pala e dëmtuar dhe pala e siguruar për kërkesën për kompensimin e dëmit, në bazë të sigurimit të përgjegjësive për dëmet që rezultojnë nga përdorimi i mjetit motorik.

Pronari i avionit të regjistruar në regjistrin shqiptar të avionëve civilë duhet të lidhë një kontratë sigurimi të përgjegjësive për çdo dëm dhe/ose humbje, shkakuar palëve të treta përgjatë përdorimit të avionit.

Pronari i mjeteve të vogla lundruese, me fuqi motorike më të madhe se 15 kw, që, sipas rregullave të regjistrimit të mjeteve lundruese, duhet të regjistrohet në regjistrin e mjeteve lundruese, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi të përgjegjësishë për dëmet pasurore dhe jopasurore, të shkaktuara ndaj palëve të treta.

NGA KODI CIVIL (I perditesuar):

I siguruari duhet t'i njoftojë siguresit, me rastin e lidhjes së kontratës, të gjitha rrethanat për të cilat ka dijeni dhe që kanë rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe të masës së rrezikut.

I siguruari gjatë kohës që kontrata e sigurimit është në fuqi detyrohet t'i njoftojë siguresit të gjitha ndryshimet e rrethanave për të cilat ka marrë dijeni pas lidhjes së kontratës së sigurimit dhe që mund të influencojë mbi shtimin e rrezikut. Në qoftë se i siguruari nuk bën njoftimin e sipërm, siguresi ka të drejtë, që nga çasti i shtimit të rrezikut, të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit, afatin e sigurimit ose të zgjidhë kontratën. Kur i siguruari nuk pranon ndryshimin ose zgjidhjen e kontratës, ka të drejtë t'i drejtohet me padi gjykatës.

Kontraktuesi detyrohet t'i paguajë siguresit primin e sigurimit në afatet e caktuara në kontratë. Në qoftë se primi ose kësti i parë i tij nuk paguhet në afat, sigurimi pezullohet deri në orën 24.00 të ditës që kontraktuesi paguan shumën që detyrohet. Kur kontraktuesi nuk paguan primet në vazhdim, sipas afateve të caktuara, sigurimi pezullohet nga ora 24.00 e ditës së pesëmbëdhjetë pas mbarimit të afatit të pagimit dhe siguresi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

Kur vërtetohet ngjarja e sigurimit, i siguruari detyrohet të njoftojë siguresin brenda afatit të parashikuar në kontratë. Në qoftë se i siguruari nuk bën këtë njoftim, siguresi ka të drejtë të mos paguajë shpërblimin e sigurimit ose shumën e sigurimit.

I siguruari ose personi i tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit, detyrohet të provojë se ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe, në sigurimin e pasurisë të provojë edhe sasinë e dëmit, si dhe t'i njoftojë siguresit, sipas kërkesës së këtij, të gjitha informatat që janë në dijeni të tij dhe që kanë lidhje me ngjarjen e 392 sigurimit. Në rastin e sigurimit të personit, kur vërtetohet humbja e aftësisë për punë, bëhet edhe ekspertimi mjekësor. Kur nuk përmbushen detyrimet e sipërme, siguresi ka të drejtë të mos paguajë shpërblimin e sigurimit ose shumën e sigurimit.

Personi që ka lidhur kontratën është i detyruar të zbatojë vetë detyrimet që rrjedhin nga kontrata, deri në momentin kur siguresi ka marrë njoftim për pranimin ose jo të saj, nga personi në emër të të cilit është lidhur kontrata

Personi që lidh kontratën e sigurimit të pasurisë ose personi i tretë, në dobi të të cilit lidhet kontrata, duhet të ketë interes pasuror në objektin e siguruar përndryshe kontrata e sigurimit është e pavlefshme.

I siguruari detyrohet të ruajë me kujdes pasurinë e siguruar, sipas dispozitave kundër zjarrit, dispozitave agronomike dhe veterinare. Siguresi ka të drejtë të kontrollojë pasurinë e siguruar dhe të kërkojë nga i siguruari që të marrë masa për ruajtjen e mirë të pasurisë dhe për zhdukjen e çrregullimeve që janë konstatuar. Kur i siguruari shkel detyrimin e sipërm, siguresi ka të drejtë të zgjidhë kontratën e sigurimit.

Kur vërtetohet ngjarja e sigurimit, i siguruari detyrohet të marrë të gjitha masat që varen nga ai për të shpëtuar dhe ruajtur pasurinë e siguar me qëllim që të ndalohet ose pakësohet dëmi.

Kur për të njëjtin rrezik sigurimi janë lidhur veçmas disa kontrata sigurimi në sigures të ndryshëm, i siguruari duhet të njoftojë secilin sigures, për të gjitha sigurimet. Kur i siguruari me qëllim nuk jep njoftimin e sipërm, siguresit nuk janë të detyruar të paguajnë shpërblimin e dëmit. Kur vërtetohet ngjarja e sigurimit, i siguruari duhet të njoftojë të gjithë siguresit, duke i treguar secilit emërtimin e të tjerëve si gurues. I siguruari ka të drejtë të kërkojë nga secili sigures shlyerjen e dëmit të detyruar sipas kontratës, por gjithsesi shumat e shlyera së bashku nuk duhet të kalojnë shumën e dëmit.